



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 32 Prot

Tiranë, më 18.05.2007

VENDIM Nr. 7 dt. 16.05.2007

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 16.05.2007, pasi shqyrtoi projektet e miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

1. Të miratojë projektet e investimeve për vitin 2007.

- Kisha e Shelbuemit, Rubik.
- Amfiteatri i Durrësit.
- Kalaja e Krujës.
- Ujësjiellësi i Vranishtit, Vlorë.
- Banesa e Filip Çekës, Shkodër.
- Banesa e Roza Sumës, Shkodër.
- Mirëmbajtje monumente kulture të kategorisë I. Shkodër (përfshihen objektet: banesa e Hodo Sokolit, banesa e Pashko Vasës, banesa e Çin Jubanit, Qendra Historike, banesa Ismet Halili).
- Mirëmbajtje monumente kulture të kategorisë së I, Dibër (përfshihen objektet: banesa e Mude e Sali Kadriut, kulla e Zunës, banesa e Rexhep Karajt, xhamia Burim-Allajbegi)
- Banesa Malo Elezi, Berat.
- Banesa Jani Pasko, Berat.
- Banesa Andon Arapi, Berat.
- Banesa në Roshnik, Berat.

2. Të miratojë projektet e restaurimit të cilat nuk janë pjesë e investimeve të buxhetit të shtetit.

- Kisha e Shën Kollit, Vuno. (Pjesë e këtij projekti të jenë edhe restaurimet nga sektori i artit)
- Rruga A-B-C-D-E-F-G-H-I, Vuno →
- Kompleksi i banimit të familjes Kasneci, Vuno. ↻
- Kisha e Shën Mëhillit, Nivan-Zagori, Gjirokastër.
- Konservimi i Ikonave.
- Restaurimi i ndërtesës së Koleksioneve Evropiane të Bibliotekës Kombëtare.

3. Të miratojë kërkesën për shpalljen Monument Kulture të objektit Burgu famëkeq i Spaçit.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
PROF. DR. YLLI PANGO**



**SEKRETARI I K.K.R.
PROF. DR. APOLLON BAÇE**

